



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.851/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Vlora Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Vlora Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, në Vendvotimet nr. 1317E/01R, 1312E/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 10.11.2017, nga Vlora Buja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilën pretendon se në vendvotimin VV nr. 1317E/01R, nuk ka asnjë vote, ndërsa i kanë figuruar 11 vota. Më tutje ka theksuar se në vendvotimin 1312E/01D nga komunikimi me kryesuesin e Këshillit të Vendvotimit është njoftuar se ka 26 vota, ndërsa nga FRKi figurojnë 16 vota, pra në këtë vendvotim është i dëmtuar për 10 vota. Prandaj PZAP-it i ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK një foto e sms e dëshmuar nga telefoni.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.851/2017 me datë 12.11.2017

Kryesuese e Panelit
Zyhdi Haxiri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.